



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI RREGULLATOR

Data: 2 Shkurt 2022

Nr: 12

V E N D I M

P Ë R

**MIRATIMIN E ORARIT TË VOTIMIT PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR NË
BASHKITË SHKODËR, DIBËR, DURRËS, VORË, RROGOZHINË DHE LUSHNJË, TË
DATËS 6 MARS 2022**

Në mbështetje të Dekretit të Presidentit nr. 13438, datë 20.01.2022, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie, për disa njësi të qeverisjes vendore”, neni 11, pika 1, neni 20, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

V E N D O S I:

1. Qendrat e votimit ku do të zhvillohen zgjedhjet e pjesshme për kryetar në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rogozhinë dhe Lushnjë, të datës 6 Mars 2022, hapen në ora 07:00 dhe mbyllen në ora 19:00.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjana NANO - Kryetare

Arens ÇELA - Anëtar

Dritan ÇAKA - Anëtar

Helga VUKAJ - Anëtare

Muharrem ÇAKAJ - Anëtar

